



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR DOGANËN E KOSOVËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi (udhëheqës ekipi), Ariana Berisha Rexhëbeqaj dhe Leonora Hasani (anëtare ekipi) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Blerim Kabashi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Qeverisja e mirë.....	17
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	22
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	24

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Doganës së Kosovës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit të dërguar me 25.10.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Doganës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Drejtori i Përgjithshëm është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Doganës së Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i DK është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

---

Ministri i Financave dhe Drejtori Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Dogana e Kosovës (DK) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së Nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike, Rregullën Financiare Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare dhe Rregulla Nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara;
- Kërkesat e Ligjit Nr. 06/L- 020 për Buxhetin Republikës Kosovës për vitin 2018;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK) dhe



- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Lidhur me PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

#### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I DOGANËS SË KOSOVËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

### 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, të hyrat, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në pajtueshmëri lidhur me zbatimin e rregulloreve dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti lidhur me fushën e personelit. Po ashtu, si rrjedhojë moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e të hyrave vazhdon të përcjellët me dobësi dhe mangësi në menaxhimin e tyre.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>9,056,651</b>	<b>9,367,650</b>	<b>8,757,325</b>	<b>8,490,434</b>	<b>7,838,762</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,056,651	9,367,650	8,757,325	8,490,434	7,838,762

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 310,999€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2018, DK ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 8,757,325€, me një rënie prej 3% krahasuar me vitin 2017.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>9,056,651</b>	<b>9,367,650</b>	<b>8,757,325</b>	<b>8,490,434</b>	<b>7,838,762</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,423,313	6,152,323	6,152,323	5,654,921	5,587,296
Mallrat dhe Shërbimet	2,294,963	2,369,963	1,821,889	1,924,564	1,565,043
Shërbimet komunale	193,375	136,475	102,579	107,510	96,595
Investimet Kapitale	1,145,000	708,889	680,534	803,439	589,828

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje ishte 729,010€. Kjo ishte si rezultat i rritjes me vendime të qeverisë, fillimisht për 121,539€ me vendimin Nr.02/70 të datës 19.10.2018, e pastaj rritjes në fund të vitit në vlerë 607,471€ me vendimin Nr.07/80 të datës 18.12.2018. Realizimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 100%.
- Pavarësisht rritjes së buxhetit për mallra dhe shërbime për 548,074 gjatë vitit, vetëm 77% e buxhetit ishte shpenzuar. Mosrealizimi i buxhetit ishte për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit tek disa projekte si: furnizim me jelek anti plumb, furnizim me pajisje të teknologjisë informative dhe kompjuterë, furnizim me banderola për miell, furnizim me një pjese të uniformës, etj. Ndërsa, tek disa pozicione si, mirëmbajtja dhe sigurimi i automjeteve, marrja me qira, trajnime jashtë vendit etj, kishte kursime të buxhetit.
- Buxheti për komunalitet ishte reduktuar për 56,900€ me vendim të Qeverisë nr. 08/76 datës 21.11.2018. Këto mjete ishin paraqitur si kursime pasi që disa nga shërbimet komunale janë mbuluar nga Ministria e Administratës Publike.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti fillestar në kategorinë e investimeve kapitale ishte 1,145,000€. Ndërsa, me kërkesë të MF dhe vendim të Qeverisë nr. 02/70 dhe nr. 07/80 janë larguar/anuluar tri projekte si: (a) Sistemi softuerik i Doganave të Kosovës sipas standardeve, (b) Sistemi i konfirmimeve me bar-kod dhe (c) Renovimi i objekteve doganore. Këto projekte kishin qenë të parapara edhe në vitin 2017 dhe njëjtë edhe atëherë ishin larguar me rishikim të buxhetit.

### Çështja B1 - Keq klasifikimi i buxhetit

**Gjetja** Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për përkufizimin e një pasurie të paprekshme kërkojnë që për t'u njohur si e tillë, ajo pasuri duhet të jetë e identifikueshme dhe nën kontroll të organizatës. Plani kontabël i aprovuar nga ana e Thesarit-MF është i ndërtuar bazuar në këto standarde dhe u shërben organizatave për klasifikim të shpenzimeve.

Dogana kishte bërë pagesë për kontratën "Furnizim me licenca për AW, BI dhe Development" në vlerë prej 195,974€ është kryer nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht nga kodi ekonomik 31680, duke e trajtuar si pasuri e paprekshme, edhe pse nuk i plotësonte kriteret për t'u njohur si e tillë. Paga ishte bërë për pajisje, licenca, garancione dhe shpenzime të mirëmbajtjes e trajnimit, që ishin shpenzime me karakter shërbimi dhe do të duhej të klasifikoheshin në mallra dhe shërbime. Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimit jo të drejtë të këtyre shpenzimeve në buxhetin e vitit 2018.

**Rreziku** Klasifikimi dhe raportimi jo i drejtë i shpenzimeve, ndikon në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e mallrave dhe shërbimeve dhe shpie në një keqkuptim të pasqyrave financiare.

**Rekomandimi B1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle më efektive që sigurojnë planifikim dhe klasifikim adekuat të projekteve bazuar në standardet e kontabilitetit dhe planin kontabël të aprovuar nga Thesari-MF.

### 3.1.1 Të hyrat

DK në përgjithësi ka një sistem mjaft efektiv në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës për vitin 2018 janë 1,175,000,000€, ndërsa të hyrat bruto të realizuara ishin 1,135,015,816€, kthimet 4,231,318€, dhe të hyrat neto ishin 1,130,784,498€.

Përkundër faktit që politikat fiskale shtetërore, marrëveshja për stabilizim-asocim - MSA, si dhe kufizimet në importin e veturave kanë prodhuar efekte negative në mbledhjen e taksave, DK ka arritur performancë mjaft të mirë, duke realizuar 96.6% të të hyrave të planifikuara.

**Tabela 3. Të hyrat e realizuara dhe kthimet sipas kodeve ekonomike në tri vitet e fundit (në €)**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma 2018</b>	<b>Shuma 2017</b>	<b>Shuma 2016</b>
Akciza në kufi	403,472,321	419,968,063	390,905,186
Akciza e brendshme	15,430,847	12,311,278	12,374,036
Dogana në import	123,747,924	125,992,685	129,931,679
TVSH në kufi-dogana	585,888,724	557,775,781	514,339,311
Masat anti damping	1,976,199	330,197	0,00
Tatimet e taksa. tjera	483,324	516,693	548,759
Kontrolli i jashtëm doganor	2,016,952	2,266,388	1,832,084
Kundërvajtje doganore	1,000,812	1,095,533	906,347
Banderolat	357,265	359,736	382,567
Të hyrat nga shitja e mallrave	408,175	269,983	198,689
Të hyrat nga gjykata	233,273	210,772	0,00
Fast-dogana	0,00	0,00	707
Kthimi i akcizës	-3,410,461	-7,590,977	-5,758,537
Kthimi i taksës doganore	-207,704	-281,883	-489,407
Kthimi i TVSH-së	-472,404	-1,027,722	-1,094,227
Kthimi taksa tjera doganore	-140,749	-243,512	-34,756
<b>Të hyrat neto</b>	<b>1,130,784,498</b>	<b>1,111,953,015</b>	<b>1,044,042,438</b>

Ne kemi analizuar menaxhimin e procesit të të hyrave me rastin e importimit të mallrave dhe përcaktimit të vlerës doganore. Vlera doganore i referohet vlerës së mallrave të importuara dhe përdoret për të llogaritur detyrimet doganore të importit dhe tatimet.

Shumica e importeve vlerësohen në bazë të vlerës së transaksionit (çmimit të kontratës/faturës), megjithatë, në qoftë se nuk është e mundur për të përdorur vlerën e transaksionit, janë pesë metoda tjera të vlerësimit të cilat mund të përdoren sipas radhës.

Ne testuam të hyrat nga Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSh), Akciza dhe Dogana. Nga testimi i mostrave për qëllime të pajtueshmërisë me legjislacionin, ne kemi parë se në tri kode tarifore, metodat nuk janë përdorur në mënyrë kronologjike sipas kërkesave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, mirëpo kjo nuk ka pasur ndonjë efekt në të hyra, ndërsa me efekt në të hyra kanë rezultuar mostrat në vijim:

---

**Çështja B2 – Mangësi në kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimi i çmimeve uniforme me rastin e rivlerësimit të mallrave për qëllime tatimore**

**Gjetja** Sipas nenit 71, pika 2 të UA nr.11/2009 për implementimin e kodit doganor dhe të akcizave, nëse, as mallrat e importuara as mallrat identike e as të ngjashëm të importuara, nuk janë shitur në kohën apo periudhë të afërt kohore, vlera doganore e mallit të importuar e caktuar sipas këtij neni, bazohet në çmimin për njësi, sipas të cilit mallrat e importuara apo identike apo të ngjashme janë shitur në Kosovë që janë vlerësuar por para kalimit të 90 ditëve pas importimit të tillë.

Zyrtarët doganorë nuk kishin marrë parasysh këtë kërkesë të udhëzimit me rastin e përcaktimit të vlerës doganore të mallit të importuar në dy raste: tek importi i artikullit - kodi tarifor 6109100000 (maica nga pambuku për të rritur) dhe importi i artikullit kodi tarifor 6807100000 (material për izolim-kondor), të importuar me terma të njëjta (biznesi, vendi originës, vendi eksportues, përshkrimi dhe kushtet e dërgesës të njëjta), në periudha të ndryshme kohore, janë vlerësuar me vlera/çmime të ndryshme për qëllime të kalkulimit të detyrimeve doganore. Detajet për secilin rast janë përshkruar në vazhdim:

a. Në Deklaratën Unike Doganore (DUD) me numër 2020-34647, datë 21.06.2018 dhe kod tarifor 6109100000, për kalkulim të detyrimeve doganore është pranuar vlera e transaksionit/faturës, e cila ishte 2,500€ për 2600 copë. Ndërkaq, në DUD-in me numër 2020-45169, datë 04.08.2018 dhe kod tarifor 6109100000, për kalkulim të detyrimeve doganore, nuk është pranuar vlera e transaksionit/faturës, e cila ishte 1,835€ për 1900/copë, por çmimi i artikujve është rivlerësuar. Me rastin e rivlerësimit, vlera është rritur në 2,850€, ku çmimi mesatar i bie 1.50 cent/copë. Për shkak të diferencës në vlerësim/çmim të artikullit, biznesi në importin e parë me vlerë transaksioni prej 2,500€ është ngarkuar me më pak detyrime doganore për 417€.

b. Në DUD-in me numër 2040-24734, datë 06.09.2018 dhe kod tarifor 6807100000 (material për izolim-kondor), për kalkulim të detyrimeve doganore nuk është pranuar vlera e transaksionit/faturës, e cila ishte 4,830€, por çmimi i artikujve është rivlerësuar. Me rastin e rivlerësimit, vlera është rritur në 11,597€, ku çmimi mesatar i bie 1.99 cent/metër. Ndërkaq, në DUD-in me numër 2040-28112, datë 06.10.2018 dhe kod tarifor 6807100000, për kalkulim të detyrimeve doganore është pranuar vlera e transaksionit/faturës 4,617€ dhe nuk është rivlerësuar. Për shkak të diferencës në vlerësim/çmim të artikullit, biznesi në importin e dytë me vlerë transaksioni prej 4,617€ është ngarkuar me më pak detyrime doganore për 958€.

Lidhur më këto raste Dogana ka marrë veprime përmes kontrollës pas importuese dhe kanë korrigjuar vlerësimin e mëparshëm të bazës doganore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të volumit të madh të rasteve të cilat i trajton një zyrtarë doganor dhe pamundësisë për të vlerësuar deklaratat doganore me kujdes më të madh.

**Rreziku** Mangësitë në kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimi i çmimeve uniforme me rastin e rivlerësimit të bazës doganore, rezulton në trajtim jo të barabartë të importuesve, si dhe zvogëlim të të hyrave doganore.

**Rekomandimi B2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për të mundësuar një proces të drejtë të vlerësimit të detyrimeve doganore, unifikim të vlerës doganore si dhe trajtim të barabartë të importuesve.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti përfundimtar për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve për vitin 2018 ishte 6,152,323€, të cilat ishin shpenzuar 100%.

DK është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të personelit në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil. Ne kemi testuar një numër të mostrave për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me legjislacionin përkatës (kodin doganor).

#### Çështja A1 - Mos azhurnimi i kontratave të punës konform Udhëzimit Administrativ Nr. 36/2016

**Gjetja** Udhëzimi administrativ Nr.36/2016 për pagat, shtesat dhe shpërblimet e zbatueshme në Doganën e Kosovës i cili ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2017 përcakton pagën bazë, shtesat, shpërblimet dhe kompensimet tjera të parapara për oficerët doganorë.

Në pesë mostrat e testuara, kemi vërejtur se kontratat e punës së oficerëve doganorë, nuk janë azhurnuar sipas gradave të përcaktuara me udhëzimin përkatës.

Kjo kishte ndodhur pasi që DK nuk ka vlerësuar si të nevojshme azhurnimin e kontratave sipas udhëzimit të ri, pasi që sipas nevojës kontratave aktuale iu ishin bashkangjitur vendimet përkatëse shtesë.

**Rreziku** Mos azhurnimi i kontratave të punës konform udhëzimit në fuqi mund të rezultojë në mosarritjen e objektivave të përcaktuara me rregullat e reja si dhe mund të rrezikojë aplikimin e parregullt të gradave të zyrtarëve doganorë dhe koeficienteve të pagave. .

**Rekomandimi A1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kontratat e punës të oficerëve doganorë të azhurnohen në përputhje me udhëzimin në fuqi, duke marrë parasysh edhe implikimin e ligjit të ri të pagave.

---

### Çështja B3- Numër i lartë i pozitive të paplotësuara

**Gjetja** Sipas UA nr. 39/2017 për Strukturën Organizative të Doganës së Kosovës dhe Ligjit të Buxhetit për vitin 2018, DK ka të aprovuara 642 pozita.

Aktualisht DK ka të plotësuara 583 pozita, ndërsa 59 pozita të tjera kanë mbetur të lira, 18 prej tyre pozita menaxheriale.

Kjo situatë ishte për shkak të anulimit të disa konkurseve dhe zhvillimit të proceseve rekrutuese fillimisht përmes avancimeve të brendshme, nga lartë poshtë.

**Rreziku** Mos plotësimi apo vonesat në mbulimin e pozitive të caktuara me kandidatë përkatës, mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e aktiviteteve operacionale dhe arritjen e objektivave të përcaktuara të Doganës.

**Rekomandimi B3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj një proces më dinamik në plotësimin e pozitive menaxhuese me rekrutime të rregullta, në mënyrë që menaxhimi të jetë më efikas dhe struktura organizative të kompletohet.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 2,369,963€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,821,889€, apo 77% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me furnizim me mirëmbajtjen e teknologjisë informative, provizione bankare, furnizim për zyrë, shërbime kontraktuese tjera, qiraja për ndërtesa si dhe mëditjet e udhëtimit zyrtarë.

Buxheti final për komunalitet në vitin 2018 ishte 136,475€. Prej tyre janë shpenzuar 102,579€, të buxhetit. Këtu hyjnë shpenzimet e rrymës dhe telefonave.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 708,889€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 680,534€, apo 96% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me softuerë dhe pajisje të teknologjisë informative.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



---

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale mbi 1,000€ në regjistrin kontabël të DK-së ishte 3,746,610.€, ndërsa vlera neto e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 394,932€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Testet tona në këtë kategori shpalosen se menaxhimi dhe raportimi i pasurive është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.3 Të arkëtueshmet

DK ka të vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Ato menaxhohen dhe kontrollohen nga sektori për menaxhimin e borxheve, që është përgjegjës për trajtimin e borxheve. Përkundër përpjekjeve të DK për mbledhjen e borxheve të krijuara gjatë vitit dhe atyre të mëhershme dhe përcjelljes së lëndëve në procedurë përbarimore dhe gjykatë vlera e tyre edhe më tej vazhdon të jetë e lartë. Në vitin 2018 vlera e tyre është 43,752,863€, që është më e lartë për 1,869,197€ krahasuar me vitin 2017. Kjo ka ndodhur për shkak se bizneset kishin kontestuar obligimet e tyre, duke paditur DK për ngarkesë të padrejtë. Kjo ka shpie në pamundësinë e ekzekutimit të borxheve përmes përbarimit, pasi ligjërisht këto konteste duhet të zgjedhën nga gjykata. Duke qenë se trajtimi përmes procedurave gjyqësore kërkon kohë dhe DK nuk ka ndikim në përshpejtimin e procedurave, çështja po vazhdon të mbetet sfidë për disa vite.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 17,693€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Ne testuam raportet mujore të obligimeve, fatura të obligimeve të prezantuara në PFV, si dhe librin e furnitorëve për dy mujorin e vitit 2019. Testet tona në këtë kategori konfirmojnë se menaxhimi dhe raportimi i obligimeve është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



---

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

DK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Doganën e Kosovës në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Dogana ka hartuar me kohë planin për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo progresi nuk është i mjaftueshëm. Komiteti i auditimit nuk kishte funksionuar gjatë gjithë vitit 2018, për t'i dhënë një shtytje më të madhe zbatimit të rekomandimeve. DK edhe në këtë vit kishte përmbushë kërkesën lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2019, plani për menaxhimin e rreziqeve si dhe plani për monitorimin e rreziqeve janë të hartuara nga ana e DK.

#### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

DK ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm që përbën një segment të rëndësishëm të kontrolleve në përgjithësi. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë - Drejtori i NJAB dhe dy auditorë. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë planifikuar nëntë (9) auditime gjatë vitit 2017. Kjo njësi ka përmbushur në tërësi planifikimin duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme. Ndryshe nga viti 2017, në vitin 2018, kishte një iniciativë më të madhe nga ana e menaxhmentit për t'i adresuar rekomandimet e NJAB.

Komiteti i Auditimit është i themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave dhe mbulon të gjitha agjencitë e saj, përfshirë edhe DK. KA për vitin 2018 kishte mbajtur vetëm dy mbledhje, duke mos qenë mjaftueshëm funksional.

**Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

DK është agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave. PFV-të e saj konsolidohen në kuadër të PFV-ve të MF-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportimit me kohë. DK ka strukturën e saj organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Drejtori i Përgjithshëm raporton te Ministri i Financave në periodha të rregullta mujore. Departamentet në kuadër të DK përgatisin plane veprimi për zbatimin e objektivave të parapara me aktivitetet e tyre operative, dhe njëherit në baza mujore dhe tremujore kryejnë monitorimin apo matjen e arritjes së objektivave të përcaktuara me plan strategjik.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara në disa raste nuk kanë qenë adekuate për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të DK ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. DK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, dy (2) ishin të mbyllur, një (1) ishte zbatuar pjesërisht dhe dy (2) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Procesi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka kontrole të mira që sigurojnë planifikim/klasifikim adekuat të projekteve bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari-MF.	DK nuk kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që e njëjta gjetje është përsëritur edhe këtë vit.	Rekomandim i pa zbatuar
2	Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet dhe janë ndërmarrë veprime për të mundësuar një proces korrekt të vlerësimit të deklaratave doganore, unifikim të vlerës doganore si dhe trajtim të barabartë të bizneseve.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje përmes kontrolles pas importuese duke korigjuar vlerësimin e mëparshëm të bazës doganore.	Rekomandim i mbyllur zbatuar
3		Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë funksionim të plotë të kontrolleve dhe procese/procedura korrekte në pikat doganore. Procedurat eksport/import të zhvillohen nga bizneset e pajisura me dokumente/licenca valide duke ofruar siguri dhe konkurrencë të drejtë në treg.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që këtë vit nuk kemi hasur në raste të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
4		Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se sistemi i kontrollit sa i përket përcaktimit të vlerës se mallrave për detyrime doganore dhe tatimore bëhet në mënyrë uniforme që përjashton mundësin për përdorimin e vlerave doganore jo të arsyeshme/parimore.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar
5	Pagat dhe shitesat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që për pozitën e mbuluar me UD të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta, dhe çështja e koeficienteve për stafin e DK të jetë e unifikuar në harmoni me kërkesat ligjore.	DK kishte ndërmarrë veprime sa i përket harmonizimit të koeficientëve ndërsa pozitën me UD ende nuk janë zgjedhur.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar;

6	Menaxhimi i personelit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme ligjore, që për pozitat e paplotësuara të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme në pajtim me kërkesat ligjore.	DK nuk kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që e njëjta gjetje është përsëritur edhe këtë vit.	Rekomandim i pazbatuar;
7	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka kontrolle të mira në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe se funksionimi i tyre të monitorohet në vazhdimësi gjatë tërë procesit.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, pasi që këtë vit nuk kemi hasur në raste të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që veprimet e ndërmarra janë të njafueshme dhe të monitoroj nga afër funksionalizimin e sistemit e-pasuria, në mënyrë që të sigurohet se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.	Rekomandim i zbatuar pasi që ka filluar përdorimi i e-pasurisë nga ana e DK.	Rekomandim i zbatuar
9	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle adekuate rreth menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, si dhe në koordinim me organet përkatëse të ndërmerren veprime në rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje, duke përcjellë të gjitha lëndët në përmbardim dhe gjykatë.	Rekomandim i zbatuar
10	Obligimet e papaguara	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle adekuate në këtë fushë, të sigurojë raportim cilësorë dhe bashkëpunim/koordinim me Avokaturën Shtetërore me qëllim të përfaqësimit adekuat të institucionit në gjykata.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje.	Rekomandim i zbatuar
11	NJAB	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë dhe komunikim efektiv në mes menaxhmentit, KA dhe NJAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe për të ndërmarrë veprime që rekomandimet e AB-së të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.	DK kishte ndërmarrë veprime për këtë çështje.	Rekomandim i zbatuar

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrole të mira që sigurojnë planifikim/klasifikim adekuat të projekteve bazuar në standardet e kontabilitetit dhe planin kontabël të aprovuar nga Thesari-MF.
2	Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të mundësuar një proces të drejtë të vlerësimit të deklarave doganore, unifikim të vlerës doganore si dhe trajtim të barabartë të importuesve.
3	Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kontratat e punës të oficerëve doganorë të azhurnohen në përputhje me udhëzimin në fuqi duke marrë parasysh edhe implikimin e ligjit të ri të pagave.
4		Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë një proces më dinamik në plotësimin e pozitave kyçe me pozita të rregullta, duke identifikuar kështu më saktë vendet e lira në mënyrë që të vazhdohet me plotësimin e strukturës organizative.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër Konfirmimi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Financave**  
**Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance**



*Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs*  
*Zyra e drejtorit të përgjithshëm*



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe



- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

**Z. Bahri Berisha**

Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës

Data: 15 Maj 2019, Prishtinë,

